

AKT THEMELIMI
I
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“CITY STREET HOTEL”

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, më 14.08.2023 (Katërbëdhjetë Gusht Dymijë e Njëzetë e Tre), ne, themeluesit, krijuam një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“CITY STREET HOTEL” SH.P.K.**

1.1. Themelues të shoqërisë janë:

1. **Z. Neritan Bizhga**, i datëlindjes 01.11.1972, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal H21101034D.
2. **Z. Valentino Bizhga**, i datëlindjes 14.02.2005, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal K50214072S.

Neni 2

Objekti

2.1 Objekti i aktivitetit të shoqërisë, pa u kufizuar në të, do të jetë:
“Hotel dhe aktivitete të tjera në fushën e hoteleri-turizmit”.

Neni 3
Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 99 vjet.

Neni 4:

Selia

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: "Rruga Nacionale Gjirokastër Kakavije, godine 7-katëshe, përballë INSIG, zona kadastrale 8541, nr.pasurie 11/159-N1, Zona Kadastrale 8541, Gjirokastër"

KREU II KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2.000.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:
1. **Z. Neritan Bizhga**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.500.000 lekë që përben 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. **Z. Valentino Bizhga**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 500.000 lekë që përben 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6

Administrimi

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.2 Personi e mëposhtëm caktohet si Administrator u parë të shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:
- Të dhënat e identifikimit:
1. **Z. Valentino Bizhga**, i datëlindjes 14.02.2005, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal K50214072S.

Neni 7
Baza Ligjore

- 7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

- 8.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente Shqiptare.

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"CITY STREET HOTEL"




